



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0120

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Vedat Poterqoi – Kryetar, Kimete Gashi - Anëtar, Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik,(OE) “Shkelqimi Invest”sh.p.k, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renocimi i shf Sadri Duhla - Laxhja Sopaj; shf Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor Lot 2 Renovimi-fasadimi i shf Kongresi i Manastirit Studenqan, Flamuri i Arberit Reshtan” me numër të prokurimit 624-22-9770-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)- Komuna Suharekë, më më datën 05.06.2023, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e Shkelqimi Invest SH.P.K. me nr. 2023/0120 , e datës 04/03/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renocimi i shf Sadri Duhla - Laxhja Sopaj; shf Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor Lot 2 Renovimi-fasadimi i shf Kongresi i Manastirit Studenqan, Flamuri i Arberit Reshtan”, me numër të prokurimit 624-22-9770-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 04.03.2023,ka pranuar ankesë nga OE “Shkelqimi Invest”sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe meremetimi i shkollave - Maqitevë; 7 Marsi dhe Komunë Lot 1 Renocimi i shf Sadri Duhla - Laxhja Sopaj; shf

Besim Ndrecaj Maqitev dhe shf. Ismet Jashari-Kumanova Javor Lot 2 Renovimi-fasadimi i shf Kongresi i Manastirit Studenqan, Flamuri i Arberit Reshtan”, me numër të prokurimit 624-22-9770-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues, Komuna Suharekë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 120/2023.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 60,123.65 €

AK ka publikuar njoftimin për kontratë më 22.09.2022, ndërsa më datë 12.10.2022 është bërë hapja e ofertave. AK më datë 28.10.2022 ka publikuar B58 Njoftim mbi vendimin e AK dhe më datë 15.02.2023 B58 Njoftimin mbi vendimin e AK pas rivlerësimit të ofertave. OE ankues më datë 20.02.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK, dhe më datë 22.02.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18 mars 2023 me raportin e ekspertizës. AK Kuvendi Komunal Suharekë, është deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ankues “Shkelqimi Invest”sh.p.k, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 18.03.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Shkelqimi Invest”sh.p.k, me seli në Prishtinë të refuzohet si e pa bazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 15.02.2023.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE “Shkelqimi Invest”sh.p.k, me seli në Prishtinë

Pretendimi nr. 1:

Në proces të rivlerësimit të tenderit AK ka kërkuar sqarime për referenca nga lista e kontratave, por nuk i ka pranuar si të vlefshme të gjitha. AK e cek si jo të vlefshme para kontratën që e kemi nënshkruar me personin fizik Asllan Shala pronar i Restorant Royal, para kontrata është bërë tek noteri në vitin 2021, noteri i ka cek tri data kur do të bëhet pagesa e punëve dhe njëra datë paska qenë gabim që edhe ne tash e kemi vërejtur, data e tretë e ka gabim vitin në vend se të jetë 2022 është 2021. Ky është gabim tërësisht teknik që e ka lëshuar noteri gjatë përpilimit të kontratës dhe nuk ka të bëjë me papërgjegjshmërinë tonë, në kemi dhënë edhe dëshmi tjera bindësi si referencën e z. Asllan Shala, foto të restorantit, Nr e tij të telefonit ku ka mund të merr me shume informacione AK. Gabimi teknik i një numri nga noteri është lehtësisht i pranueshëm dhe nuk ka aspak nxitje për dyshime për deri sa kontrata tek noteri është bërë me shumë se 1 vit dhe nuk ka

të bëjë aspak me përpilimin e dokumenteve për këtë tender po ashtu edhe vërtetësinë e ekzekutimit të atij projekti AK nuk ka qenë fare e interesuar ta bëjë, sepse edhe qëllimi i AK nuk ka qenë të shpërblehet oferta jonë as për herë të parë e aq me pak tash kur këtë lëndë për vlerësim të parë e kemi dërguar në OSHP, dhe OSHP vendimin 667-22 e kthen në favor të kompanisë tonë, duke e detyruar AK që lënda të kthehet në rivlerësim (pika kryesore e ankesës tonë ka qenë se AK ka kaluar tek oferta e shtrenjtë pa u ndalur tek oferta jonë për të kërkuar sqarime).

Përgjigje në pretendimin nr.1:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar nga OE ankues lidhur me këtë pretendim, ekspertja shqyrtuese sqaron se data 30.08.2021 e kështit të tretë e paraqitur në kontratën e prezantuar nga OE ankues të lidhur me personin fizik Asllan Shala do të mund të merrej parasysh si gabim teknik në rast se OE do të ofronte si dëshmi transaksionet bankare nga personi fizik Asllan Shalla në llogarinë e OE pasi në këtë rast do të ishte lehtë e verifikueshme dhe do të vërtetohej me dokument zyrtar nga banka që do të vërtetonte ekzistencën e tij para datës së hapjes së ofertave. OE në oferten e tij ka bashkangjitur qarkullimin për llogari në emër të OE “Shkelqimi Invest Sh.P.K.” por nuk kam vërejtur ndonjë transaksion bankar më datë 30.08.2022 nga personi fizik Asllan Shala në llogarinë e OE. Prandaj ky pretendim i OE është i paqëndrueshëm.

Pretendimi nr. 2:

Një pikë tjetër është edhe CV e inxhinierit, kjo na duket një arsyetim sa për ta bërë ofertën tonë të papërgjegjshme përsëri AK ka refuzuar ofertën tonë pa kërkuar sqarime. AK ka mund të kërkojë sqarime për ndonjë dëshmi të përvojës së inxhinierit dhe jo ta eliminoni ofertën tonë, edhe pse se është cek sa vite ti këtë përvojë sipas rregullave data e diplomës na tregon për përvojën që ka inxhinieri, CV e tij është ajo që e kemi dorëzuar ndërsa dëshminë e përvojës AK e ka kërkuar veçmas kësaj. DMTH është kërkesë e ndarë nga CV, përderisa ka qenë dokument veq AK ka mund të kërkojë sqarime. Po e citojmë kërkesën e KA në dosje të tenderit: III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia2 - Kontrata e punës ose para kontrata me inxhinierin, Diploma e NOTERIZUAR, dokument dëshmi mbi përvojën e punës dhe një CV . Pra shihet se AK ka kërkuar ndër tjerash dëshmi të përvojës së punës DHE një CV që d.m.th. nuk qëndron pretendimi i AK-se se CV nuk i përmbush kërkesat sepse dëshmia është kërkuar ndaj dhe kërkesa për informacione është dashtë të bëhet nga AK për dëshmi të përvojës.

Përgjigje në pretendimin nr.2:

Lidhur me këtë pretendim, ekspertja shqyrtuese sqaron se CV e prezantuar për Ing. Bekim Mustafa nga OE nuk është e kompletuar dhe sipas nenit 39 paragrafi 39.8 të RRUOPP-së (që ishte në fuqi) dhe nenit 10 të Udhëzuesit nr.001/2023 për prokurim publik sqaron:

CV-ja e dorëzua nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Sipas nenit 69 të LPP-së
---------------------------------------	---	--------------------------

Prandaj ky pretendim i OE është i paqëndrueshëm.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Me vendimin nr.667/22 të datës 12.12.2022, aktiviteti i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim duke e aprovuar ankesën me nr. 667/22 të dt. 17.11.2022 si të bazuar, për faktin se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar konform neneve, 72 të LPP dhe 39 të RRUOPP duke mos kërkuar sqarime lidhur me dokumentacionin e ofruar me ofertën e OE ankues. PSH i konsideron pretendimet si të pabazuara, ngase pas sqarime të kërkuara OE ankues nuk ka arritur të bind PSH po as ekspertin shqyrtues se me ndonjë dokument shtesë apo transaksion bankar (konform nenit 69 të LPP) se kontrata e sipërshtënuar me personin fizik z. Asllan Shala do të duhej të merret parasysh dhe të futet në vlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE ankues “Shkelqimi Invest”sh.p.k, me seli në Prishtinë të refuzohet si e pa bazuar dhe që të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 15.02.2023.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues dhe sqarimit të tij, vlerëson se ky pretendim ankimor është i paqëndrueshëm, sepse CV-ja e prezantuar për Ing. Bekim Mustafa nga OE nuk ishte e kompletuar dhe nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe bindëse se Inxhinieri në fjalë e ka përvojën e kërkuar konform Dosjes së Tenderit.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK pas ri-vlerësimi të aktivitetit të prokurimit dhe veprimit për marrjen e masave sipas nenit 72 të LPP dhe nenit 39 të RRUOPP, AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, meqë e ka hartuar dosjen e tenderit në pajtim me kërkesat e domosdoshme, të parashikuara shprehimisht me dispozitën e nenit 27 (Dosja e Tenderit) lidhur me nenin 28 (Specifikimet teknike) të Ligjit të cituar kurse kriteret e aplikuar dhe veprimet e ndërmarra nuk karakterizohen me natyrë diskriminuese. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104

lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Shkelqimi Invest SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: